FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për përdoruesin

LORADERM

Shurup – 5 mg / 5 ml
(Loratadinë)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.
- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Loraderm dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Loraderm
3. Si ta merrni Loraderm
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Loraderm
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË LORADERM DHE PËRSE PËRDORET

Loraderm është emri i preparatit që vjen tek pacienti në formën e shurupit. Ky shurup ka si përbërës aktiv loratadinën.
Loratadina është një antihistaminik josedativ me veprim të gjatë dhe me veprim antimuskarinik të dobët. Loratadina antagonizon veprimin e histaminës në sajë të aftësisë konkuruese për receptorët H1 të histaminës.
Loratadina përdoret për trajtimin simptomatik të gjendjeve alergjike si:
- rinit e urtikarie kronike;
- shtim i sekrecioneve nazale;
- tështima;
- kruajtje të hundëve dhe syve;
- kruajtje të lëkurës etj.

2. PËRPARA SE TË MERRNI LORADERM

Mos merrni Loraderm në qoftë se jeni i ndjeshëm (alergjik) ndaj loratadinës (përbërësi aktiv) ose ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të shurupit Loraderm.

Tregoni kujdes të veçantë me Loraderm
Pyesni mjekun tuaj përpara se të merrni shurupin Loraderm.
- Në qoftë se keni dëmtim të funksionit të mëlçisë; në këtë rast doza fillestare duhet të jetë më e ulët.
- Në qoftë se keni dëmtim të funksionit të veshkës; në këtë rast doza fillestare duhet të jetë më e ulët.
- Në qoftë se vuani nga tensioni i lartë; loratadina mund të shkaktojë rritje të tensionit.
- Në qoftë se vuani nga retensioni urinar.

Administrimi i shurupit Loraderm duhet ndërprerë të paktën 48 orë përpara se t'i nënshtroheni testeve të lëkurës; loratadina mund të parandalojë, pakësojë ose përndryshe të shkaktojë reaksion pozitiv ndaj indikatorëve dermalë.

Marrja e barnave të tjera:
Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga shurupi Loraderm.
Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me shurupin Loraderm në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit.

Është veçanërisht e rëndësishme që mjeku juaj të jetë në dijeni të faktit që ju jeni trajtuar me:
- eritromicinë, klaritromicinë (antibakterialë); frenojnë metabolizmin e loratadinës;
- ketokonazol (antimykotik); frenon metabolizmin e loratadinës;
- cimetidinë (bar për trajtimin e ulçerës së stomakut, aciditetit në stomak dhe refluksit acid).

Shtatzënia
Kërkoni këshillën e farmacistit ose të mjekut përpara se të merrni këtë bar!
Akoma nuk është vërtetuar përdorimi i sigurt i loratadinës gjatë shtatzënisë, prandaj nuk rekomandohet përdorimi i këtij shurupi gjatë shtatzënisë.

Ushqimi me gji
Loratadina kalon në qumështin e gjirit dhe prandaj nuk duhet që ky shurup të përdoret gjatë ushqimit të foshnjes me gji.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Efekti i këtij bari mbi aftësinë për të drejtuar automjetin dhe përdorur makineri përcaktohet pas dozave të para dhe është individual. Megjithatë, këshillohet të tregohet kujdes në rastin e drejtimit të automjetit apo në kryerjen e punëve që kërkojnë vëmendje të lartë gjatë përdorimit të shurupit Loraderm.

3. SI TA MERRNI LORADERM

Gjithmonë merreni shurupin Loraderm sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni të sigurt, kontaktoni me mjekun ose farmacistin. Në qoftë se ndjeni që efektet e shurupit janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.
Shurupin mund ta merrni me ose pa ushqim.

Dozimi:
- *Të rriturit dhe fëmijët mbi 12 vjeç*

10 ml shurup (që përmbajnë 10 mg loratadinë) një herë në ditë.
- *Fëmijët nga 2 deri në 12 vjeç*

Kësaj kategorie pacientësh i këshillohet dozimi në bazë të peshës trupore. Fëmijëve me peshë trupore mbi 30 kg u këshillohet 10 ml shurup (që përmbajnë 10 mg loratadinë) një herë në ditë.
Fëmijëve me peshë trupore 30 kg ose më pak u këshillohet 5 ml shurup (që përmbajnë 5 mg loratadinë) një herë në ditë.
Efikasiteti dhe siguria e përdorimit të loratadinës tek fëmijët nën 2 vjeç nuk është përcaktuar akoma.
- *Dëmtim i funksionit të mëlçisë*

Rekomandohet që kjo kategori pacientësh të fillojë mjekimin me doza më të ulëta.
Të rriturit dhe fëmijët me peshë trupore më shumë se 30 kg
Këshillohet një dozë fillestare prej 10 mg loratadinë, çka do të thotë 10 ml shurup në ditë të alternuara.
Fëmijë me peshë trupore 30 kg ose më pak
Këtyre fëmijëve duhet që fillimisht t'u jepet 5 mg loratadinë, pra 5 ml shurup, në ditë të alternuara.
- *Dëmtim i funksionit të veshkave*

Nuk kërkohet përndryshim i dozës tek të moshuarit apo tek pacientët me dëmtim të funksionit të veshkave.

Në qoftë se keni marrë më shumë shurup Loraderm
Në qoftë se keni marrë më shumë shurup se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.
Mbidozimi me loratadinë thekson simptomat antikolinergjike që vijnë nga përdorimi i loratadinës. Përgjumja, takikardia dhe dhimbja e kokës mund të jenë simptoma të tjera të mbidozimit.

Në qoftë se keni harruar të merrni shurupin në kohën e duhur:
Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.
Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, edhe shurupi Loraderm mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston.

Efektet mbi SNQ (Sistemi Nervor Qendror)
Deprimimi i SNQ është një nga efektet anësore të zakonshme i të gjithë antihistaminikëve.
Loratadina, si një antihistaminik josedativ, ka një përshkueshmëri të ulët në SNQ dhe një afinitet më të lartë për receptorët H1 periferikë të histaminës krahasuar me ata qendrorë. Studimet me loratadinën në përgjithësi kanë treguar një incidencë më të ulët të aftësive sedative dhe të efekteve të tjera që kanë të bëjnë me SNQ krahasuar me efektet e vërejtura nga antihistaminikët e vjetër, krahasuar gjithashtu me placebo.

Efektet mbi Sistemin Kardiovaskular
Hipertension, palpitacion, takikardi, sinkop.

Efektet dermatologjike
Dermatit, flokë të thatë, tharje e lëkurës, kruarje të lëkurës, fotosensibilizim, shtim i djersitjes.

Sy – Veshë – Hundë - Grykë
Turbullim i shikimit, dhimbje veshi, dhimbje syri, ndryshim i perceptimit të shijes.

Trakti Gastro – intestinal
Tharje e gojës, dhimbje barku, rritje e oreksit dhe shtim në peshë, të përziera, të vjella.

Efektet në Traktin Urogenital
Çngjyrosje e urinës, mbajtje e urinës.

Efektet në mëlçi
Funksionim jo normal i mëlçisë duke përfshirë verdhëzën dhe hepatitin.

Efektet në Sistemin Respirator
Vështirësi në frymëmarrje, tharje të mukozës së hundës, tështitje.

5. SI TA RUANI LORADERM

Mbajeni larg fëmijëve.
Mos e përdorni shurupin Loraderm pas datës së skadimit e cila është e shënuar në paketim.
Të mos ruhet në temperaturë mbi 25°C.
Ruajeni shurupin në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban shurupi Loraderm
Lënda vepruese është loratadina.
5 ml shurup përmbajnë 5 mg loratadinë.
Përbërësit e tjerë janë: propilenglikol, hidroksipropilmetil celulozë, glicerinë, sakarinë natriumi, benzoat natriumi, acid citrik, EDTA - dinatriumi, esencë qitroje dhe vaniljeje, ujë i pastruar.

Përmbajtja e paketimit
Kuti me 1 shishe 120 ml.
Kuti me 1 shishe 150 ml.

Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:

Mund të merret pa recetën e mjekut.

Nuk duhet të përdoret gjatë shtatzënisë.

Përmbajtja. Kujdes. Shurup.

Mbajtësi i autorizimit për tregtim (MAT) dhe prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.Fax: 00355 4 2362800
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Janar 2015.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.